

NEWSLETTER

Maj



PJESË E  KASTRATI GROUP

**Udhëto i Sigurt,
Bli Online
Sigurimin e Shëndetit
në Udhëtim në Albsig**

**Albsig Mbështet
Bienalen e Arkitekturës
që u Mbajt në Venecia**

**Panairi i Karrierës në UMT,
me Mbështetjen e Albsig,
Një Hap më Pranë
Suksesit Profesional**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP





Panairi i Karrierës në UMT, me Mbështetjen e Albsig, Një Hap më Pranë Suksesit Profesional

Në prag të mbylljes së një tjetër viti të suksesshëm akademik, Universiteti Metropolitan Tirana organizoi Panairin e Punës dhe Karrierës në muajin Maj. Jo vetëm studentët e UMT, por risia e këtij viti ishte edhe pjesëmarrja e hapur për studentë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend. Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me tregun e punës për secilin nga fakultetet respektive, pasi të pranishëm në këtë panair ishin rreth 50 biznese më në zë të industrive të ndryshme si ajo e telekomunikacionit, bankare, teknologjike, tregut të sigurimeve, zhvillimet kompjuterike, kompani rekrutimesh por dhe agjenci dhe institucione qeveritare. Ky Panair i Punës dhe i Karrierës, këtë vit u organizua në shenjë të "Dual Studies", nismës më të re të Universitetit Metropolitan Tirana për t'u ofruar studentëve mundësi punësimi gjatë periudhës së studimeve, sipas një procesi të rregulluar. Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjithmonë është spikatur si mbështetëse e brezave të rinj në rrugën e karrierës. Kompanitë e pranishme në event ekspozuan ofertat mbi praktikat mësimore, internshpet, mundësitë e punësimit, trajnimet dhe workshop-et. Albsig.sh.a, pjesë e Kastrati Group, ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj punëkërkuessve të rinj, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë personale dhe profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfutur sadopak eksperiencë në fushën e

sigurimeve. Shoqëria e Sigurimeve Albsig ofron mjedisin e duhur për zhvillimin profesional dhe mundësinë e aplikimit të aftësive për profesionistët njëkohësisht mbështet shumë fort dhe brezin e ri të studentëve. Stendën e Albsig e vizituan dhe aplikuan rreth 60 studentë, ku shumica prej tyre, përveç kërkesave për internshipet, kërkuan dhe mundësi punësimi dhe praktike profesionale. Ndërkaq, Rektori i Universitetit Metropolitan Tirana, Prof. Dr. Nikolla Civici u shpreh: *“Ne kujdesemi jo vetëm për një arsimim të mirë, nëpërmjet programeve cilësore dhe stafit cilësor, por edhe për t’i afruar studentët me kompanitë në mënyrë që ata të punësohen. Dhe ky aktivitet ka dhënë sukseset e veta. Mbi 80% e studentëve që përfundojnë studimet në universitetin tonë janë punësuar, shumica e tyre në profesionin për të cilin kanë studiuar”.* Rektori prezantoi më tej edhe risitë e UMT gjatë këtij viti si akreditimi i plotë institucional, hapja për herë të parë në Shqipëri e programit Bachelor të Inteligjencës Artificiale dhe “Dual Studies”. *“Ne kaluam akreditimin institucional me rezultate shumë të mira. Në këtë moment të gjitha programet e studimit janë të akredituara. Një arritje tjetër e rëndësishme është hapja e shkollës së doktoraturës në universitetin tonë, pranë Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, në fushën e Inteligjencës Artificiale dhe Sistemeve Inteligjente në bashkëpunim me universitete në Francë dhe në Shtetet e Bashkuara dhe tre studentët e parë të përzgjedhur tashmë kanë filluar aktivitetin e tyre kërkimor dhe jemi në kërkim të rekrutimit të pesë studentëve të tjerë që do të fillojnë aktivitetin gjatë vitit në vazhdim. Gjithashtu do të hapim një program Bachelor në fushën e Inteligjencës Artificiale. E reja që dua të ndaj me ju është edhe nisja e programit “Dual Training”, thënë ndryshe “Studim dhe Punësim”. Ai ofron avantazhe për studentët, kompanitë, universitetin dhe ekonominë kombëtare pasi rregullon kërkesën dhe ofertën në tregun e punës dhe nxit punësimin brenda vendit. Rezultatet arrihen përmes koordinimit dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit”,* – sqaroi më tej Civici, duke ftuar kompanitë pjesëmarrëse të bëhen pjesë e kësaj nisme. Përfaqësuesit e departamenteve të Burimeve Njerëzore të kompanive pjesëmarrëse diskutuan me studentët mbi mundësitë reale të punësimit dhe praktikave të nevojshme mësimore, të cilat do u vijnë në ndihmë gjatë profilizimit të tyre në tregun shqiptar të punës.





La Biennale di Venezia
2023

Albsig Mbështet Bienalen e Arkitekturës që u Mbajt në Venecia

Pavijoni shqiptar në Ekspozitën Ndërkombëtare të Arkitekturës në "La Biennale di Venezia" interpreton temën e përgjithshme "Laboratori i së Ardhmes" nëpërmjet ekspozitës "Përsiatje të Pakohë". Kuruar nga Era Merkuri dhe Martin Gjoleka, kjo ekspozitë është realizuar në bashkëpunim me Ani Markun dhe Geraldo Prendushin. Ekspozita vë në pyetje kuptimin e ripërtëritjes të hapësirës publike dhe rolin e arkitektit si agjent ndryshimi. Një odise virtuale, e cila nis me disa vëzhgime në dy hapësira publike në Tiranë, Stadiumin Dinamo dhe Liqenin Artificial – dy zona që po përballen me vështirësitë e kohës, një stadium bosh që nuk përdoret mjaftueshëm dhe tjetra që mbipërdoret. Një ndër mbështetësit e realizimit të këtij eventi kaq të rëndësishëm është edhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group. Thirrjes së ministrisë i është përgjigjur menjëherë Albsig, e cila është një ndër kompanitë që ka mbështetur dhe mbështet gjithmonë risitë në të gjitha fushat. "Këta arkitektë po sjellin diçka nga ideniteti ynë. Kanë sjellë dy vende, por që mund të jenë një stadium dhe një liqen që mund të jetë kudo në botë. Po studiojnë se cila do të jetë e ardhmja e arkitekturës në kohën e inteligjencës artificiale. Gjithashtu jemi të lumtur që sjellin këtu në Bienale një skuadër arkitektësh të rinj", – tha Margariti. Nëpërmjet ekspozitës, pavijoni i fton vizitorët të mendojnë thellë mbi mundësitë dhe realizimet e ndërlidhjeve ndërmjet njerëzve, mjedisit dhe teknologjisë. Projekti fitues që prezanton vendin tonë në Venecia u përzgjedh nëpërmjet një thirrjeje të hapur për projekt-propozime shpallur nga Ministria e Kulturës në rolin e komisionerit të pavijonit të Shqipërisë, në vijim të dy fazave të procesit selektiv, nga një juri ndërkombëtare e përbërë nga Berina Kokona, Simon Battisti, Eugen Kallfani, Erfort Kuke dhe Arjan Ymeri. Bienalja e Arkitekturës do të jetë e hapur për publikun deri më 26 Nëntor 2023.




**Si mësojmë të jetojmë
në realitete të sintetizuara!**



Udhëto i Sigurt, Bli Online Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim në Albsig.

Keni një udhëtim pune? Keni planifikuar pushimet me familjen apo me shoqërinë? Mos harro të pajisesh me Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim në Albsig. Çmime shumë të mira dhe kushte komode. Mundësi blerjesh fizike dhe online me ofertat më të mira për klientët dhe jo vetëm. Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim ka qëllim të mbrojë të siguarin në raste aksidentesh apo urgjencash shëndetësore që mund t'i ndodhin gjatë periudhës kur ndodhet jashtë vendit. Polica e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim mbulon shpenzimet emergjente mjekësore dhe shpenzimet e nevojshme të riadhesimit, deri në vlerën maksimale të shpenzimeve të përcaktuara në formularin e Policës së Sigurimit. Si pjesa dërrmuese e produkteve të sigurimit, blerja e tyre mbi baza vullnetare është shumë e ulët. Kjo Policë Sigurimi, në shumicën e rasteve blihet sepse është një dokument që kërkohet në kufi nga autoritetet e vendeve pritëse, nuk blihet vullnetarisht nga gjithsecili klient që mendon të kalojë sadopak kohë jashtë vendit. Edhe pas heqjes së vizave me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, kjo policë ka ngelur pjesë e dokumentacionit që kërkohet në momentin e hyrjes në hapësirën Schengen.

Bazuar në statistikën e buletinit të AMF, për periudhën Janar-Prill primet e shkruara bruto për Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim janë rritur me 11.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Konkretisht shprehur në vlerë monetare Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim për periudhën Janar-Prill shkon në 110.940 milion lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte 99.642 milion lekë. Vlen për t'u theksuar se gjatë katër muajve të parë të vitit, shqiptarët kanë rritur ndjeshëm shpenzimet për të siguruar jetën, shëndetin dhe pronën edhe pse rastet më të shumta janë të ndikuar nga bankat. Totali i arkëtimeve të kompanive për periudhën Janar-Prill ka shkruar në rreth 65 milion euro, me një rritje të fortë krahasuar me vitet e mëparshme. Sipas të dhënave zyrtare të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, arkëtimet nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajt Janar-Prill 2023 kapën vlerën 6,8 miliardë lekë, ose 16.75 % më shumë se në Janar-Prill 2022. Gjatë muajve Janar-Prill 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 384,225 me një rritje prej 14.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.67% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, Sigurimet e Jetës kanë 8.31% dhe Risigurimi 0.021%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të Sigurimit Vullnetar zënë 46.69% dhe primet e shkruara bruto të Sigurimit të Detyrueshëm zënë 53.31% të totalit të tregut. Ndërkohë që rënie kanë shënuar dëmet e paguara nga kompanitë.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL